



RREGULLORJA E GJELBËR

1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të vendosë dhe të promovojë praktika të përgjegjshme ndaj ambientit në zyrën tonë, të zvogëlojë ndikimin tonë mjedisor, të ruajë burimet natyrore dhe të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore. Përmes zbatimit të kësaj rregulloreje, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) synon të krijojë një vend pune më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm, të zvogëlojë gjurmën e karbonit të organizatës dhe të kontribuojë në mbrojtjen e ambientit, më gjegjësisht.

QKSS zotohet të demonstrojë leadership në këtë fushë duke i integruar politikatat e gjelbërta në të gjitha praktikatat e veta organizative.

2. FUSHËVEPRIMI

I gjithë stafi i QKSS-së duhet t'i nënshtrohet kësaj rregulloreje, pa dallim prej pozitës së tyre apo kohëzgjatjes së punësimit. Kjo përfshin stafin me orar të plotë, atyre me orar të pjesshëm apo me orar të përkohshëm. Punonjësit e QKSS-së gjithashtu këshillohen që të angazhohen në praktika të mira mjedisore edhe jashtë ambienteve të zyrës së QKSS-së, duke përfshirë këtu gjatë eventeve si konferencat, trajnimet, seminarët, etj.

3. ZOTIMET

1. Përdorimi i ujit

QKSS do të bëjë çdo përpjekje për të kursyer ujin në baza ditore. QKSS do të pajisë çdo anëtar të stafit me shishen e vet të ujit, shishe kjo e cila është shumë-përdorimëshe. Sipas mundësive, stafi i QKSS-së do të:

- Shmangë përdorimin e ujit të ambalazhuar në shishe plastike një-përdorimëshe, duke pirë ujë nga rubineti ose duke pirë nga bidoni i ujit.



2. Përdorimi i plastikës

QKSS do të bëjë çdo përpjekje për të reduktuar blerjen dhe përdorimin e plastikës një-përdorimëshe, duke eksploruar produkte alternative të cilat janë të biodegradueshme. Sipas mundësive, stafi i QKSS-së do të:

- Shmangë përdorimin e gotave, enëve dhe qeseve plastike një-përdorimshe. Në vend të tyre, stafi do të përdorë alternativa si shishe uji shumë-përdorimshe, gota, dhe pjata ose enë ushqimore plastike shumë-përdorimshe.

3. Riciklimi i materialeve plastike

QKSS do të vendosë një kosh mbeturinash në kuzhinë i cili do të shërbejë për riciklimin e materialeve plastike. Nga stafi i QKSS-së pritet që sa herë që përdorin plastikë një-përdorimshe:

- T'i ndajnë materialet plastike të riciklueshme nga artikujt e tjerë të pa riciklueshëm, duke i hedhur në koshin e veçantë të riciklimit të plastikës.

4. Përdorimi i letrës

Stafi i QKSS-së duhet të përpiqet të ruajnë dhe riciklojnë letrën kurdo që është e mundur. Sipas mundësive, stafi i QKSS-së do të:

- Përpiqen të shmangin printimin e materialeve për evente, sikurse agjendat, dhe në vend të tyre të përdorin alternativa digjitale.
- Maksimizojnë opsionet e printimit dhe kopjimit duke e aplikuar printimin e dyanshëm për cdo printim.
- Ripërdorin letrën që veçse është printuar në njërën anë për të mbajtur shënime.



5. Ruajtja e energjisë elektrike

Stafi i QKSS-së duhet të bëjë çdo përpjekje për të kursyer energjinë elektrike në baza ditore. Sipas mundësive, stafi i QKSS-së duhet të:

- Fikin dritat dhe pajisjet elektronike kur nuk janë në përdorim, duke përfshirë edhe në fund të orarit të punës/ditës.
- Reduktojnë konsumin e energjisë në periudhën e dimrit duke e rregulluar temperaturën e termostatit.

6. Higjiena e përgjithshme në zyrë

Stafi i QKSS-së duhet të bëjë çdo përpjekje për t'i mbajtur ambientet e zyrës të pastra dhe higjienike. Sipas mundësive, stafi i QKSS-së do të:

- Mbajjnë rregullisht hapësirën e tyre të punës të pastër dhe të rregullt, duke përfshirë zyrën e përbashkët dhe tualetet.
- Shmangin lënien e enëve të kuzhinës si gotat, shishet ose pjatat, qofshin ato të pastra apo të pista, në ambientet e zyreve, duke përfshirë edhe zyrën e përbashkët.
- Pastrojnë vetë enët e kuzhinës kur i përdorin ose t'i vendosin në makinën për larjen e enëve.
- Mbajjnë tualetet e pastra pas përdorimit.
- Shmangin hedhjen e cigareve në vende të pacaktuara, si p.sh. dyshemetë e ballkoneve ose zona të jashtme të gjelbëruara përreth zyrës.



4. MASAT DISIPLINORE

I gjithë stafi i QKSS-së pritet t'i përmbahet kësaj rregulloreje, në mënyrë që si organizatë të promovojmë ruajtjen dhe zvogëlimin e ndikimit tonë negativ në mjedis. Mosrespektimi i zotimeve të përcaktuara në këtë rregullore do të rezultojë në marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësit përgjegjës për shkeljen. Masat specifike disiplinore për palët shkelëse janë të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores së QKSS për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

5. HYRJA NE FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 Mars 2023. Nga kjo datë e sipër, i gjithë stafi i QKSS-së pritet të jetë në përputhje me rregulloren dhe kërkesat e saj. Rregullorja do të rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës për të siguruar që ajo të mbetet aktuale dhe efektive në promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore brenda vendit të punës.

Rregullorja hyn në fuqi: 01/03/2023

Mentor Vrajolli,


Drejtor Ekzekutiv